

MuKi Deutsch

## Unë mësoj gjermanisht – fëmija im gjithashtu

Kurse në gjuhën Gjermane dhe kurse integrimi për nënat që flasin një gjuhë tjetër dhe për fëmijët e tyre parashkollorë të moshës 3 deri në 5 vjeç.

Komuna e Köniz –it ofron në tri vende kurse të gjermanishtes dhe kurse integrimi për nënat dhe fëmijët e tyre parashkollorë, të ashtuquajturat MuKi Deutsch - kurset e gjermanishtes.

Nëse ende e flisni shumë pak gjuhën Gjermane apo nuk e flisni dhe nuk e kuptoni fare dhe nëse keni një fëmijë të moshës në prag të hyrjes për në kopsht të fëmijëve, atëherë ky është kursi i gjermanishtes që ju përshtatet.

### A keni pyetje p.sh. si vijon?

- Përse duhet të mësoj gjuhën Gjermane.
- Që të kuptoheni në përditshmëri.
- Nga se mësoni më shumë lidhur me jetën në Zvicër.
- Ju mundësohet të shkëmbeni përvojat me nënat e tjera.
- Ju dini se si funksionon sistemi ynë shkollor dhe mund të bisedoni me mësuesit për fëmijën tuaj.
- Ju mund ta përkrahni më mirë fëmijën tuaj në shkollë.
- Dhe, gjersa ju mësoni gjermanisht jeni një shembull për fëmijën tuaj.

### A mund ta vizitohet MuKi Deutsch kursin e gjuhës Gjermane nëse nuk di të shkruaj dhe të lexoj ?

Jo. Ju duhet ta lexoni dhe ta shkruani alfabetin latin.

### A mund ta vizitohet MuKi Deutsch kursin e gjuhës Gjermane nëse nuk banoj në Komunën e Köniz-it?

Parimisht, kurset mbahen për gratë që banojnë në komunën e Köniz-it. Nëse në ndonjë kurs ka ende vende të lira mund të bëhen edhe përjashtime.

### Çfarë moshe duhet të kenë fëmijët për MuKi Deutsch kursin e gjuhës Gjermane?

Normalisht rreth moshës 3 deri në 5 vjeç. Fëmijët më të vegjël se kjo moshë, në marrëveshje me udhëheqësen e projektit apo mësuesen e kursit mund të merren nën përkuqjesje.



shqip  
albanisch

### Përse është MuKi Deutsch kursi i gjermanishtes i mirë për fëmijën tuaj?

- Nga se ai mëson shumë gjëra të reja dhe mund të luajë me fëmijët e tjerë.
- Fëmija i juaj dëgjon tregime në gjermanisht dhe këndon këngë.
- Dhe mbi të gjitha fëmija i juaj mëson gjermanisht, e kjo i lehtëson atij hyrjen në kopsht.

### Si është i organizuar një MuKi Deutsch kurs i gjuhës Gjermane?

Kursi fillon pas pushimeve të vjeshtës dhe zgjatë një vit. Ju mësoni gjermanisht 2 orë në javë dhe materiali i mësimit ju jepet në kurs. Në kursin e fëmijëve, fëmija i juaj do të jetë nën përkuqjesjen e udhëheqëseve me përvojë të kursit dhe do të avancohet prej tyre në aspektin gjuhësor. MuKi Deutsch kurset e gjermanishtes mbahen në komunën e Köniz-it, Köniz Buchsee, Hessgut Liebfeld dhe Schliern Blindenmoos.

### Si dhe deri kur mund të paraqitem për kurs?

Plotësojeni talonin e regjistrimit dhe e dërgoni atë deri në afatin e caktuar për regjistrim në adresën e shkruar në pjesën e prapme të talonit.

### Sa kushton një MuKi Deutsch kurs i gjuhës Gjermane?

Kursi kushton 245.00 franga dhe paguhet në fillim të kursit.

### A jemi, unë dhe fëmija im, gjatë kursit të siguruar?

Jo. Ju duhet ta keni sigurimin tuaj në rast aksidenti dhe një sigurim për detyrim zhdëmtimi

### Ku mund të informohem edhe më tutje?

Bei der Fachstelle Bildung der Gemeinde Köniz, Stapfenstrasse 13, 3098 Köniz, Tel. 031 970 92 93.  
E-Mail: fachstelle.bildung@koeniz.ch.

Kjo broshurë mund të shkarkohet nga interneti në gjuhë të ndryshme:

<http://www.koeniz.ch/erwachsenenbildung>



MuKi Deutsch

Bitte frankieren - .85

MuKi Deutsch-Kurse  
Gemeinde Köniz  
Abteilung Bildung, Soziale Einrichtungen und Sport  
Erwachsenenbildung  
Stapfenstr. 13  
3098 Köniz